



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 562 / Prot. 10

Tiranë, më 12/5/2017

REKOMANDIM

Nr. 10, datë 12/5/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "Ministria e Punëve të Brendshme", Tiranë;

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 83, datë 24.03.2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "Ministria e Punëve të Brendshme", me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesve e ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në kuadër të përpunimit të të dhënave gjatë implementimit të projektit "Për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren".

Hetimi pranë këtij kontrolluesi u iniciua nga Zyra e Komisionerit bazuar në indiciet/ankesat e ardhura nga qytetarë të ndryshëm, publikimet në median audio-vizive dhe atë të shkruar si dhe interesin publik që paraqet mbrojtja e të dhënave personale që përpunohen në kuadër të implementimit të projektit të përbashkët të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike "Për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren".

Kontrolluesi "Ministria e Punëve të Brendshme" me qëllim për të pasur një Regjistër të integruar të Adresave dhe Shtetasve dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 110, datë 06.08.2015, "Për ngritjen e grupit ndër-institucional të punës për menaxhimin qendror të projektit: Për plotësimin dhe vënien në funksionim të sistemit të ri të adresave", ka filluar një projektin për plotësimin dhe vënien në funksionim të sistemit të ri të adresave, i cili parashikohet të përfundojë brenda vitit 2017.

Për zbatimin e këtij projekti, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 207, datë 16.03.2016, "Për ngarkimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sha) si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për llogari të vet dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme", është ngarkuar kontrolluesi Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sha).

Në funksion të projektit, kontrolluesi “Ministria e Punëve të Brendshme” ka vënë në dispozicion të OSHEE-së ndërfaqen e komunikimit me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Adresave për aksesimin në terren të të dhënave të tipit gjurmë rrugësh me emërtimet përkatëse, gjurmën e ndërtesës dhe numërtimin përkatës të saj, për të bërë verifikimin dhe regjistrimin në terren të të gjithë bazës së të dhënave për sa i përket realizimit ose heqjes së gjurmës së ndërtesave si dhe shtimin e informacionit karakteristik të hyrjeve të ndërtesave, numërtimin e kateve për hyrjet përkatëse dhe numërtimin e apartamenteve.

Përmes ndërfaqes së komunikimit me Regjistrin Kombëtar të Adresave dhe Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, të vënë në dispozicion nga kontrolluesi, kryhet aksesimi i të dhënave të personave, duke mundësuar regjistrimin e të dhënave të gjendjes civile për personat në apartamentet respektive dhe krijimin e një bazë të dhënash ndërmjetëse që përdoret për indeksimin e personit me adresën reale të tij.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 9887, dt. 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, Zyra e Komisionerit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kontrolluesin “*Ministria e Punëve të Brendshme*”, ka konstatuar se:

Kontrolluesi “Ministria e Punëve të Brendshme” nuk e ka dërguar për mendim pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale projektin përfundimtar “*Për Identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren*, sipas parashikimit të nenit 31/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.

*Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishëm, dërgimin për mendim të projekteve të tilla për vetë rëndësinë që kanë, por sidomos për sasinë e madhe të të dhënave personale që përpunohen për implementimin e tyre. Dhënia e mendimeve për projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrolluesit vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë, në zbatim edhe të parashikimeve të nenit 31/1/a të ligjit, u shërben kontrolluesve duke i orientuar për të kryer një përpunim të ligjshëm të dhënave duke respektuar dhe garantuar parimet për mbrojtjen e të dhënave personale.*

Kontrolluesi “Ministria e Punëve të Brendshme” për zbatimin e këtij projekti përpunon të dhënat personale:

- *Numrin personal*, me qëllim për të bërë indeksimin midis personit dhe adresës përkatëse;
- *Emër, atësi, mbiemër*, me qëllim saktësimin e informacionit në raste gabimesh në numrin personal apo në raste mungese të kartës së identitetit;
- *Statusin e subjektit të të dhënave “Emigrant”*, me qëllim përmbushjen e objektivave të përcaktuara në ligjin nr. 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë”;
- *Marrëdhënia e subjektit të të dhënave me objektin në pronësi, me qira, në përdorim*, me qëllim për të përcaktuar natyrën e dokumentit që do të bashkëngjitet deklaratimit të personit, për të vijuar me plotësimin e dokumentacionit që vërtetojnë qëndrimin ose pronësinë e vendbanimit përkatës, për të vijuar puna nga zyra e gjendjes civile për ndryshimin e adresës së personit;
- *Qëllimin e përdorimit*, me qëllim për të përcaktuar nëse adresa e personit në vendbanimin përkatës do të jetë adresë kryesore apo sekondare.

Në kuadër të zbatimit të detyrimit për njoftim, nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008

*“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, u konstatua se kontrolluesi “Ministria e Punëve të Brendshme”, ka përmbushur detyrimin për njoftim, por nuk është përditësuar ndryshimi i gjendjes së njoftimit në kuadër të implementimit të këtij projekti të ri.*

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit gjatë hetimit administrativ të ushtruar pranë kontrolluesit *“Ministria e Punëve të Brendshme”* si dhe nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së konstatoi se Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, për rolin e saj si kontrollues më vetë, për të dhënat që përpunon në zbatim të Ligji nr.10129, datë 11.5.2009, *“Për gjendjen civile”*, i ndryshuar, nuk ka përmbushur detyrimi për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar.

Në paragrafin 1, të nenit 21, të ligjit të sipërcituar, parashikohet: *“...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji”.*

Detyrimi për të njoftuar si dhe përditësuar njoftimin nëpërmjet *“Formularit të Njoftimit”* është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

Në përfundim të hetimit administrativ është mbajtur procesverbali i konstatimit dhe në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, në datën 18.04.2017 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesit e kontrolluesit kanë deklaruar se, *nuk kemi informacion në lidhje me moszbatimin e detyrimit ligjor për njoftim, si dhe për faktin pse nuk është dërguar për mendim pranë Zyrës së Komisionerit projekti “Për Identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren”.*

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 21, 22, 29, 30, 31 pika 1/ “a/1” dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi *“Ministria e Punëve të Brendshme”*, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
2. Kontrolluesi *“Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile”* në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, të plotësojë detyrimin për njoftim.
3. Kontrolluesi *“Ministria e Punëve të Brendshme”*, në zbatim të nenit 31 pika 1/a, të ketë në vëmendje dërgimin për mendim të projekt-akteve, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen në të ardhmen nga kontrolluesi vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë.

4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 15 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 12/5/2017

